

STATUT  
I  
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR "VELLEZERIT SHABANI" SHPK

Kreu I  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**FORMIMI I SHOQËRISË**

Neni 1

Sot me datën 01 Qershor 2023 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "VELLEZERIT SHABANI" shpk, me vullnetin e lirë të ortakut, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "VELLEZERIT SHABANI" shpk, formohet nga ortakët themelues:

- 1. Flori Fetah Shabani**, i datëlindjes 28-08-1989, i biri i Fetah dhe Lirie lindur ne Shtane /ALB dhe banues nr Durres, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, identifikuar me pasaporte te shtetit Shqiptare me nr identifikimi I90827009S.
- 2. ARSILONA NDRIQIM SHABANI**, i datëlindjes 13-01-1996, i biri i Ndriqim dhe Fitore lindur ne CANAJ/Alb dhe banues Durres, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, identifikuar me pasaporte te shtetit Shqiptare me nr identifikimi J65113075V.

Te cili me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", kanë vendosur të destinonjë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.  
Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "VELLEZERIT SHABANI" SHPK., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Neni 2

- Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Emërtimi i Shoqërisë është: "VELLEZERIT SHABANI" SHPK.
- Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjti emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

**SELIA E SHOQËRISË**

NENI 3

- Shoqëria tregtare "VELLEZERIT SHABANI" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e **Republikës së Shqipërisë në Durres, Xhafzotaj, Rruga e Fllakes, Objekt me numer pasurie 344/29, Zona Kadastrale 3852**
- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqesimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.

5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

### **KOHËZGJATJA**

#### **Neni 4**

1. Shoqëria Tregtare "VELLEZERIT SHABANI " SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

#### **Neni 5**

Objekti i shoqërisë "VELLEZERIT SHABANI " SHPK do të jete:

Autoservis Kamionash dhe automjeteve të ndryshme motorrike , Riparim, ringjyrosje dhe risprucim i mjeteve motorrike dhe motorçikletave ,Kamionave . Shitjen e blerjen me shumice e pakice të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, bujqësor, blegtoral, elektroshtepiak, makineri e paisje, material ndertimi, automjete, aggregate e makineri bujqësore, vegla auto, vajra lubrifikante etj. Eksport import. Bar restorant. Perpunim skrapë, shkrirje metali. Agjensi turistike dhe artikuj sportive, arme gjahu. Blerje, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio. Mbledhja, depozitimi, shkatërimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimi apo të braktisura. Riparim dhe mirembajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparim dhe mirembajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparim dhe mirembajtja e karrocërve të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparim dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial dhe materialeve drusore, Transporti i materialeve drusore dhe industriale.

### **TË DREJTAT E SHOQËRISË**

#### **Neni 6**

Shoqëria tregtare "VELLEZERIT SHABANI " SHPK., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortaket zhvillojnë në menyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin , seline, kohezigjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin , sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

#### **Neni 7**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë ( një qind mijë lekë) , i cili është tërësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndare në 2 (dy) kuota me vlerë nominale 51,000 lekë ( pesedhjetë një mijë lekë) DHE 49,000 lekë ( dyzetente mijë lekë).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

**FLORI SHABANI**, zotëruar i një kuote apo 51 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 51,000 lekë ( pesedhjetë e një mijë lekë).

**ARSILONA SHABANI**, zotëruar i një kuote apo 49% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 49,000 lekë ( dyzetente mijë lekë).

Kapitali fillestar nuk është paguar.

#### **NENI 8**

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.

#### **NENI 9**

1. Perberja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçante përcaktohen nga Ortaket sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjisllacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve perkatëse të rrjedhura prej tij.

#### **NENI 10**

1. Shoqëria Tregtare "VELLEZERIT SHABANI" SHPK., është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emër të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

#### NENI 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqërisë do të mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortaket dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakëve të saj.

#### NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rruge trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

#### NENI 13

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar behen të transferueshme.

#### NENI 14

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakëve.

#### NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo I zvogëlimi i tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

### KREU I DYTË

#### ORTAKËRIA

#### NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregtare "VELLEZERIT SHABANI" SHPK., gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, dhe në Statutin e Shoqërisë. Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve

#### NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

### KREU I TRETË

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **FLORI SHABANI**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjetore dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

#### ASAMBLEJA

#### NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Ajo do të beje vleresimin e kuotes sipas tregut ne rastet kur njeri prej ortakëve kerkon te shese pjesen e tij.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

#### NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë

#### TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

#### NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike ;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

#### NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licencuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori.

Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

**FORCAT MADHORE**

**NENI 25**

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij për arsye të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

**SHPËRNDARJA E SHOQËRISË**

**NENI 26**

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Shoqëria mund të priset para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsye të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**BAZA LIGJORE**

**Neni 27**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

**RUAJTJA E SEKRETIT**

**Neni 28**

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

**DISPOZITA TË FUNDIT NENI 29**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

**NENI 30**

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

**NENI 31**

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKET:**

**FLORI SHABANI**

**ARSILONA NDRIQIM SHABANI**

*FLORI SHABANI*

*Arsilona Shabani*

